

LIGJI
MBI REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PATUNDSHME
NË PRONËSINË SHOQËRORE

Ky Ligj është shpallur në "Gazetën zyrtare të KSA të Kosovës", nr. 37/71.

Neni 1

Pasurit e patundshme në pronësinë shoqërore, pos pasurive të patundshme në përdorim të përgjithshëm, si dhe të drejtat që personat e ndryshëm juridikë-shoqëror i kanë në ato pasuri të patundshme (e drejta e shfrytëzimit) regjistrohen në librat publike të tokës me shënimin e menjëhershëm të bartësit të së drejtës së shfrytëzimit.

Cdo ndryshim i bartësit të të drejtave të shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme në pronësinë shoqërore duhet të regjistrohet në librat publike në të cilat regjistrohet pasuria e paluajtshme dhe të drejtat për to.

Pasuri të patundshme në vështirësi të kësaj ligje janë tokat dhe ndërtesat.

Neni 2

Si bartës të së drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore mund të regjistrohen bashkësitë shoqërore-politike, organizatat punuese e organizatat tjera vetëqeverisëse, si dhe organizatat shoqërore-politike e shoqatat e qytetarëve, të cilat e kanë fituar këtë të drejtë në pasuri të patundshme.

Si bartës i të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore, të cilat i shfrytëzojnë njësitë ushtarake e institucionet ushtarake, regjistrohet Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë- Sekretariati federativ për mbrojtjen popullore.

Neni 3

Regjistrim i pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore bëhet:

1. në bazë të vendimit me formë të prerë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent, me të cilin konstatohet se pasuria e patundshme ka kaluar në pronësinë shoqërore.
2. në bazë të kontratës së vërtetuar e cila përmban dispozitën se pasuria e patundshme mund të regjistrohet si pasuri shoqërore.
3. në bazë të deklaratës së njëanshme të vërtetuar me të cilën pronari i pasurisë së patundshme heqë dorë prej të drejtës së pronësisë në dobi të bashkësisë shoqërore.

Neni 4

Intabulimi i të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore bëhet në bazë të vendimit me formë të prerë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent, me të cilin caktohet kjo e drejtë, bartet në dobi të një personi juridik të caktuar, si dhe në bazë të kontratës së vërtetuar, kur me ligjë është caktuar se kjo e drejtë mund të bartet me kontratë.

Në qoftë se nga dokumenti në bazë të të cilit bëhet intabulimi i pasurisë së patundshme në pronësinë shoqërore nuk mund të konstatohet kush është bartës i të drejtës së shfrytëzimit regjistrohet komuna në territorin e të cilës gjendet ajo pasuri e patundshme.

Intabulimi në bazë të alinesë 2 të këtij neni do të bëhet në bazë të propozimit të kuvendit të komunës, në të cilin vëretohet se në pasurinë e patundshme gjegjëse nuk ka të drejtë shfrytëzimi personi tjetër juridik.

Neni 5

Autorizohet sekretari krahinor i legjislacionit dhe i jurisprudencës që, sipas nevojës, të nxjerrë dispozita konkrete mbi procedurën për regjistrimin në librat publike të tokës e të pasurive të patundshme në pronësinë shoqërore dhe të drejtat e shfrytëzimit, mbi përmëbajtjen e propozimeve për intabulim, mbi dokumentat që duhet paraqitur dhe mbi çështje të tjera teknike në lidhje me intabulimin.

Neni 6

Intabulimet e bëra në bazë të Ligjës mbi intabulacionin e pasurive të patundshme në pronësinë shoqërore ("Fletorja zyrtare e RSFJ", nr. 12/65) konsiderohen si intabulime të bëra në bazë të kësaj ligje.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës", e do të aplikohet prej 1 janarit të vitit 1972.
